



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Org. Org.Jednica Org.Unit	SP-02	Nr.Prot Broj.Prot Prot.No.	917-2/26
Nr. Hfaqeve Broj.stranica No.pages	04	Data Datum Date	21.09.26
PRISHTINË/A			

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.09.2026
REFERENC-Ë:	26/917/MMPH
PËR/ZA/TO:	"V - KASTRATI" SH.P.K. Pejë Bazë e betonit në Gorazhdec, Pejë.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/917/MMPH, datë 03.03.2026, të parashtruar nga operatori "V - KASTRATI" SH.P.K. Pejë për bazën e betonit në Gorazhdec, Pejë.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore për operatorin "V - KASTRATI" SH.P.K. Pejë për bazën e betonit në Gorazhdec, Pejë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/917/MMPH
Datë: 17.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "V - KASTRATI" SH.P.K. Pejë, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/917/MMPH, datë: 03.03.2026, për bazën e betonit në ngastrën kadastrale nr. 00210-1, Z.K. Gorazhdec, Pejë.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore me nr. prot. 26/917/MMPH, datë: 03.03.2026, të operatorit "V - KASTRATI" SH.P.K. Pejë për bazën e betonit në Gorazhdec, Pejë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ



MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 04.03.2026 si në vijim:

- Në formularët e kërkesave për Leje Mjedisore për 3 kompanitë nuk janë të deklaruarat vlerat financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë.

Operatori ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë me datë 16.03.2026 si në vijim:

- Formularin e plotësuar me deklarimin e vlerës financiare të investimit të projektit (euro).

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur me datë 16.06.2026 pas kontrollimit të lëndës në bazë administrative ka vërejtur se lënda nuk është e plotësuar në bazë administrative dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 24.06.2026 i ka kërkuar operatorit plotësim të dokumentacionit shtesë si në vijim:

- Lejen Ujore për shfrytëzim të ujit nga ARPL për betonierë;
- Lejen ujore për shkarkim të ujit nga ARPL për betonierë.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë të kërkuar.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori "V - KASTRATI" SH.P.K. Pejë për bazën e betonit në Gorazhdec, Pejë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur më lartë në afatin kohorë të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.